



INSTITUCIONET E PËRKOHSHME TË VETËQEVERISJES
PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT
PRIVREMENE INSTITUCIJE SAMOUPRAVLANJA

QEVERIA E KOSOVËS - GOVERNMENT OF KOSOVO - VLADA KOSOVA

MINISTRIA E PUNËS DHE E MIRËQENIES SOCIALE
MINISTRY OF LABOUR AND SOCIAL WELFARE
MINISTARSTVO RADA I SOCIJALNE ZAŠTITE



Në përputhje me nenin 5 të Rregullores nr. 2001/19 mbi Degën e Ekzekutivit të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë,
Duke pasur parasysh nenin 15 të Ligjit nr. 2003/02 për Menaxhimin e Financave Publike, si dhe
Me qëllim të rregullimit të drejtë dhe shfrytëzimit në mënyrë racionale të parasë së gatshme (Petty Cash), Sekretari i Përhershëm i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, nxjerr këtë:

UDHËZIM ADMINISTRATIV NR.06/2007

PËR RREGULLAT E PËRDORIMIT TË PARAVE TË GATSHME

Neni 1 Qëllimi

Ky Udhëzim Administrativ ka për qëllim t'i rregulloj dhe përcaktoj rregullat dhe procedurat për realizimin e pagesave financiare në para të gatshme, për nevojat e ndryshme të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale

Neni 2 Fushëveprimi

Ky Udhëzim Administrativ do ti rregulloj të drejtat për pagesa financiare në formë të gatshme, formë e cila nuk shkakton implikime të drejtpërdrejta buxhetore

Neni 3

Përkufizimi i parave të gatshme

Paratë e gatshme janë një fond i vogël i parave që mbahet nën përkujdesjen dhe kontrollin e Sekretarit të Përhershëm, dhe që shfrytëzohet për të mbuluar shpenzimet dhe blerjet e vogla të paparashikueshme.

Neni 4

Zyrtari përgjegjës

Zyrtari përgjegjës për para të gatshme, është personi zyrtar i caktuar nga Sekretari i Përhershëm i MPMS-së, ai është përgjegjës për sigurinë e fondit, për procedimin e pagesave nga ky fond, për barazim me thesarin dhe për rimbushje të fondit.

Neni 5

Rregullat e punës rreth parave të gatshme

Zyrtari përgjegjës për para të gatshme i mban paratë e imëta në një kasafortë, dhe nuk i lejon ato përveç se në raste kur merret autorizimi përkatës. Të gjitha transaksionet në para të imëta do të regjistrohen në librin e arkës sapo të realizohen.

Neni 6

Revizioni i parave të gatshme

Zyrtari në cilësinë e verifikuesit të parave të gatshme (revizori), e bën numërimin e parave të imëta së paku një herë në muaj, dhe konfirmon nëse gjendja barazohet me librin e arkës, të cilin e mban zyrtari i parave të imëta. Të gjitha mosbarazimet i komunikohen Drejtorit Ekzekutiv Financiar e rrjedhimisht edhe Sekretarit të Përhershëm.

Neni 7

Shfrytëzimi i parave të gatshme

Fondi i parave të gatshme do të shfrytëzohet për të paguar:

- Artikuj të ndryshëm sipas rastit në vlerë të vogël, por që janë të nevojshme për funksionimin e Ministrisë,
- Për artikuj dhe shërbime të paplanifikuara në buxhet,
- Pagesat për reprezentacion sipas vendimit të Ministrit dhe Sekretarit të Përhershëm të Ministrisë deri në 100 €

Neni 8
Pamundësia e përdorimit të parave të gatshme

Paratë e gatshme nuk mund të përdoren për:

- Shpenzimet që mund të bëhen (realizohen) përmes procedurave normale financiare,
- Pagesat komunale,
- Mallrat ose shërbimet në vlerë prej më shumë se 100 €
- Pagesat për të punësuarit apo për përfitimet e tyre,
- Pagesa për pajisje (artikuj) apo shërbime personale për punëtorët,
- Pagesa për udhëtime dhe shpenzime konferencash,
- Lëshim të huave në avancë për personelin,
- Lëshim avancë për udhëtime zyrtare.

Neni 9
Ndalesat e pagesave në të gatshme

Asnjë zyrtar i MPMS-së, nuk mund të kërkojnë fatura të shumëfishta nga një furnitor për të zvogëluar shumën e faturave individuale në më pak se 100 €, me qëllim të realizimit të një pagese nga paratë e gatshme.

Neni 10
Zbatimi

Për zbatimin e drejt dhe efikas të këtij Udhëzimi Administrativ nën mbikëqyrjen e Sekretarit të Përhershëm të MPMS, do të përkujdesen Drejtori Ekzekutiv Financiar në MPMS dhe Zyrtari përgjegjës për para të gatshme.

Neni 11
Hyrja në fuqi

Ky Udhëzim Administrativ hyn në fuqi, ditën e nënshkrimit nga Sekretari i Përhershëm i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale.

Prishtinë, mars 2007

Sekretari i Përhershëm i MPMS-së

Eshref Shabani